




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANËS DURRËS

Nr. 5864 Prot.

Durrës, më 09 /04/2026

Lënda: Kërkesë për Shpallje Publike Publike

Drejtuar: DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE
DREJTORISË SË BURIMEVE MBËSHTETËSE



Në vijim të marrjes së masave për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor, mbështetur në Ligjin "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 të D.P.D-së "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës", Kreu VI "Njoftimi i Vendimit", pika 3, b) "Rastet e mos marrjes së konfirmimit të njoftimit", si dhe në zbatim të nenit 130-141/a të Kodit të Procedurës Civile, Ju drejtohem për të mundësuar njoftimin online/në faqen zyrtare të DPD-së, të subjektit/shtetasit debitor të poshtëshënuar pasi ana jonë nuk është mundësuar: **Lajmerimi për Ekzekutim Vullnetar të Urdherit të Ekzekutimit.**



Nr	Subjekti Debitor		Shuma e Borxhit	Nr, Date Vendimi		Titullit Ekzekutiv		Urdheri I Ekzekutimit	
1	KAPITENI I ANIJES M/V"AYA ZANOUBYA" MOHAMMAD AKRAN SALLIT DHE SHOQERIA "EMMA MARITIME CORPORATION"	PASS.0082920, IMO 7702994	76,098,775	258	23.04.2025	50	26.05.2025	3285	05.12.2025

Ju falenderojmë për bashkëpunimin!

**KRYETARI
DRILON BUSHATI**

V. 258/2025

Bordhil
dt. 16.02.2026
[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË
TIRANË

Nr. JCMIS: 300001-06495-80-2025
Nr. Regj. Them. 3285

Data e regjistrimit: 17.07.2025
Data e vendimit: 05.12.2025

V E N D I M

“MBI KËRKESËN PËR LËSHIMIN E URDHËRIT TË EKZEKUTIMIT”

GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË TIRANË
me trup gjykues të përbërë nga:

GJYQTAR: LEDIO SALI

asistuar nga sekretare gjyqësore **Selina Çomo**, në Tiranë, sot më datë 05.12.2025 mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve, kërkesën për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit që i përket:

- KËRKUES:** Dega e Doganës Durrës
- OBJEKTI:** Lëshim Urdhëri Ekzekutimi
- BAZA LIGJORE:** Neni 280 i Ligji 102/2014 datë 31.07.2017, Kodit Doganor/ Nenit 103 i ligjit 61/2012 "Për Akcizën në Republikën e Shqipërisë", neni 511 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata, pasi shqyrtoi kërkesën për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit si dhe provat shkresore të paraqitura nga kërkuesi,

V Ë R E N:

Dega e Doganës Durrës i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesën për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin nr. 50 datë 26.05.2025, nr. 8263 prot., datë 26.05.2025 “Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor/akcizë” (në vijim “Vendimi për rikuperimin me forcë të borxhit doganor/akcizë”). Vendimi për rikuperimin me forcë të borxhit doganor/akcizë është nxjerrë nga Dega e Doganës Durrës lidhur me shtetasi sirian “Mohammad Akran Sallit”, me PASS N.0082920, kapiten i anijes “M/V AYA Zanoubya”, si dhe për shoqërinë “EMMA MARITIME CORPORATION”.

Vendimi për rikuperimin me forcë të borxhit doganor/akcizë i është njoftuar debitorit.

Në këto kushte, duke pretenduar se vendimi nr. 50 datë 26.05.2025, nr. 8263 prot., datë 26.05.2025 “Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor/akcizë” është bërë titull ekzekutiv që nga momenti që i është njoftuar debitorit, Dega e Doganës Durrës i është drejtuar gjykatës me kërkesë për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit.

Në lidhje me bazueshmërinë në ligj dhe në prova të kësaj kërkesë, gjykata sjell në vëmendjes se aktet që përbëjnë tituj ekzekutivë janë përcaktuar në nenin 510 të Kodit të Procedurës Civile (në vijim “KPC”). Nga përmbajtja e gërmës “e” të kësaj dispozite, rezulton se tituj ekzekutivë janë edhe “aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë dhe ngarkohet zyra e përbarimit për ekzekutimin e tyre”. Ndërkohë, në nenin 280 pika 4 të ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (në vijim “Kodi Doganor”) parashikohet se: “4. Vendimet e marra nga administrata doganore për zbatimin e masave garantuese dhe/ose për rikuperimin me forcë të borxhit bëhen tituj ekzekutivë menjëherë sapo ato i njoftohen debitorit.”.

Duke interpretuar në mënyrë sistematike nenet 95 e vijues si dhe nenin 280 të Kodit Doganor, gjykata çmon se vendimet e marra nga administrata doganore për rikuperimin me forcë të borxhit doganor bëhen tituj ekzekutivë vetëm nëse plotësohen në mënyrë kumulative këto kushte:

- (i) Autoriteti doganor i ka njoftuar debitorit shumën e detyrimit/borxhit doganor dhe afatin për shlyerjen e këtij borxhi;
- (ii) Nuk rezulton që borxhi doganor të jetë shlyer si dhe nuk rezulton që të jetë vendosur pezullimi i ekzekutimit të detyrimit;
- (iii) Autoriteti doganor i ka njoftuar debitorit vendimin për rikuperimin me forcë të borxhit doganor.


Duke u kthyer në çështjen konkrete, gjykata çmon se plotësohen në mënyrë kumulative kushtet ligjore që vendimi “Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor/akcizë” i Degës së Doganës Durrës të konsiderohet titull ekzekutiv dhe i aftë për t’u vënë në ekzekutim.

Gjykata çmon se titulli ekzekutiv është i aftë për t’u ekzekutuar si në lidhje me detyrimin prej 18,897,138 (tetëmbëdhjetë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë) lekë në formë detyrimi doganor, si dhe 56,691,414 (pesëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e një mijë e katërqind e katërmëdhjetë) lekë në formë sanksionesh si dhe kamatëvonesat e arrira deri në momentin e ekzekutimit të detyrimit, përfundim ky që rrjedh nga interpretimi sistematik i neneve 107 dhe 280 pika 6 e Kodit Doganor.

Në të tilla kushte, gjykata arrin në përfundimin se duhet lëshuar urdhri i ekzekutimit për vendimin nr. 50 datë 26.05.2025, nr. 8263 prot., datë 26.05.2025 “Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor/akcizë” të Degës së Doganës Durrës, me kreditor Dega Doganës Durrës, me debitor shtetasi sirian “Mohammad Akran Sallit”, me PASS N.0082920, kapiten i anijes “M/V AYA Zanoubya”, si dhe për shoqërinë “EMMA MARITIME CORPORATION”, me detyrim 18,897,138 (tetëmbëdhjetë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë) lekë në formë detyrimi doganor, si dhe 56,691,414 (pesëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e një mijë e katërqind e katërmëdhjetë) lekë në formë sanksionesh, si dhe kamatat ligjore të arrira deri në momentin e ekzekutimit të detyrimit, të cilat do të përlllogariten sipas nenit 107 të Kodit Doganor.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, mbështetur në nenet 510 gërma “e” dhe 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe në nenet 20 dhe 22 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”



VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv vendim nr. 50 datë 26.05.2025, nr. 8263 prot., datë 26.05.2025 “Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor/akcizë” të Degës së Doganës Durrës.
3. Për ekzekutimin e titullit ekzekutiv ngarkohet shërbimi përbarimor gjyqësor dhe/ose strukturat e mbledhjes me forcë të detyrimit pranë Degës së Doganës Durrës.
4. Ky urdhër ekzekutimi lëshohet vetëm në një kopje.
5. Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim.

U shpall në Tiranë, sot më datë 05.12.2025.

SEKRETARE

SELINA ÇOMO

A handwritten signature in black ink, appearing to be "Selina Çomo", written over the printed name.

